



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR  
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS

OPINION  
MBI  
KANDIDATIN Z. {...}, I CILI KA APLIKUAR PËR T'U KOMANDUAR SI  
NDIHMËSMAGJISTRAT PRANË GJYKATËS SË LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në shkronjën “ë”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “d” të nenit 86, në shkronjën “b”, pika 1, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 53, 54, 56, 57 dhe 58, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe pikën 4, të nenit 34, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, mbi kërkesën e Gjykatës së Lartë, sipas Shkresës nr. 1607 prot., datë 17.07.2020 dhe shkresës nr. 1607/1 prot., datë 20.07.2020, me vendimin nr. 258 datë 23.07.2020 ka vendosur:

- 1. Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë.*
- 2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Gjykatën e Lartë, për pesë pozicione të lira si “ndihmësmagjistrat”.*
- ....*
- 3. Afati i paraqitjes së kërkesës për komandim është deri më datë 04.09.2020.*

Brenda afatit të paraqitjes së kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër ka paraqitur kërkesën me numër prot 4021, date 01.09.2020 me anë të së cilës ai shprehet se “...omissis...*duke e konsideruar përgjegjësi e nder mundësinë e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë me dëshirën për të kontribuar në ushtrimin e detyrave kushtetuese e ligjor në këtë pozicion, në funksion të zgjidhjes së problematikave të krijuara nga mbingarkesa dhe dhënies së kontributit veçanërisht në fushën e së drejtës administrative konform Vendimit nr.258, datë 23.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor shpreh interesin për të kandiduar për komandimin në pozicionin e ndihmës magjistratit në Gjykatën e Lartë...*”.

Gjyqtari z. {...} është caktuar gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër me Vendimin nr.6, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në nenin 54, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me procedurën e komandimit, ndër të tjera parashikohet se: “Këshilli, brenda dy javëve pas afatit të aplikimit, përgatit një opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ose prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin. Opinioni për çdo kandidat publikohet në faqen zyrtare të Këshillit. Kandidati, komandimi i të cilit nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ose prokurorisë, përjashtohet nga komandimi. Këshilli, brenda dy javëve pas afatit të kandidimit, i dërgon institucionit në të cilin do të bëhet komandimi emrat e kandidatëve që plotësojnë kriteret e pozicionit përkatës...”

Në respektim të këtij parashikimi ligjor, lidhur me vlerësimin e Këshillit, bazuar në pikën 11 të vendimit nr. 258 datë 23.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me procedurën e komandimit, ndër të tjera parashikohet se: *”Brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të kandidimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinione të miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli vendos përjashtimin e kandidatit nga komandimi kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera të komandimit”*

**Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, nga raportimet periodike dhe informacioni e mendimi i marrë nga drejtuesi i Gjykatës rezulton si më poshtë:**

Nga informacioni i marrë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, si dhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër rezultoi se : *“Kjo gjykatë ka në organikë 4 (katër) gjyqtarë, aktualisht aty janë të dekretuar 4 gjyqtar. Një gjyqtar është i pezulluar si pasojë e rivlerësimit kalimtar, gjithashtu është emëruar në mënyrë të përkohshme për një periudhë një vjeçare ( deri më 15.06.2021) një gjyqtar dhe aktualisht e bën përsëri 4 numrin e gjyqtareve që ushtrojnë efektivisht detyrën“. Në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Shkodër prej datës 1 Janar 2020 deri në datën 09 Shtator 2020 janë në ngarkim te gjyqtareve 1907 çështje dhe aktualisht deri sot më datë 9 Shtator 2020 janë në gjykim 1381 çështje gjyqësore. **Gjyqtarit {...} prej datës 1 Janar 2020 deri në datën 9 Shtator 2020 i kanë kaluar përmes shortit 471 çështje gjyqësore. Ka gjykuar 116 çështje dhe aktualisht deri më datë 9 Shtator 2020 ka në proces gjykimi 355 çështje gjyqësore. Gjyqtarës {...} prej datës 1 Janar 2020 deri në datën 9 Shtator 2020 i kanë kaluar përmes shortit 483 çështje gjyqësore. Ka gjykuar 164 çështje dhe aktualisht deri më datë 9 Shtator 2020 ka në proces gjykimi 7319 çështje gjyqësore. Gjyqtarit {...} prej datës 1 Janar 2020 deri në datën 9 Shtator 2020 i kanë kaluar përmes shortit 467 çështje gjyqësore. Ka gjykuar 53 çështje dhe aktualisht deri më datë 9 Shtator 2020 ka në proces gjykimi 414 çështje gjyqësore. Gjyqtarit {...} prej datës 1 Janar 2020 deri në datën 9 Shtator 2020 i kanë kaluar përmes shortit 486 çështje gjyqësore. Ka gjykuar 193 çështje dhe aktualisht deri më datë 9 Shtator 2020 ka në proces gjykimi 293 çështje gjyqësore”.***

Përveçse sa më lart, në lidhje me analizën e mos cenimit të funksionalitetit të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, ku gjyqtari ushtron detyrën, bazuar dhe në përgjigjen e përcjellë nga zv, Kryetari i Gjykatës pas kërkesës së Këshillit për të dhënë opinion, rezultoi se : *Omissis...“ Duke marrë në konsideratë ngarkesën aktuale të secilit gjyqtar, raportuar konform kërkesës Tuaj, faktin që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër është aktualisht me organikë të plotë, trendin e çështjeve gjyqësore të depozituara në Gjykatë në vazhdimësi dhe faktin që, edhe në situatën e komandimit të gjyqtarit {...}, mundësohet formimi i trupës gjyqësore për gjykimin e çështjeve gjyqësore me tre gjyqtarë, vlerësoj se, komandimi i gjyqtarit {...}, në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, nuk cenon interesin më të lartë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Në kuadër të opinionit vlerësues, lidhur me funksionalitetin dhe interesin më të lartë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, çmoj të rëndësishme të nënvizoj se, ngarkesa aktuale e secilit gjyqtarë, është rrjedhojë e faktit që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër për një periudhë të gjatë kohe ka funksionuar me një gjyqtar të vetëm dhe, caktimi në pozicionin e gjyqtarëve {...} dhe {...}, është pasuar nga pezullimi i veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit, të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, përjashtuar veprimtaria dhe shërbimet gjyqësore, që lidheshin me çështje me natyrë të ngutshme, konform Vendimeve Nr.127, datë 10.03.2020, Nr.128, datë 24.03.2020, Nr.133, datë 06.04.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe, Aktit Normativ Nr.9, datë 25.03.2020, miratuar me ligjin Nr.30/2020, datë*

*16.04.2020, ndryshuar me Aktin Normativ Nr.21, datë 27.05.2020. Në këtë kuptim, nisur nga ngarkesa aktuale e secilit gjyqtarë, veçanërisht e gjyqtarit {...}, dhe trendi i çështjeve gjyqësore të depozituara në Gjykatë në vazhdimësi, vlerësoj se komandimi i gjyqtarit {...} në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, nuk cenon interesin më të lartë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, dhe as normalitetin funksional të saj ”.*

Në respektim të këtij parashikimi ligjor si edhe nga analiza e të dhënave (organika e kësaj gjykate dhe numrit të çështjeve që janë në gjykim), lidhur me **vlerësimin e Këshillit, nëse komandimi është në përputhje me interesat e larta të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin**, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës çmon se, në rastin konkret, komandimi i këtij gjyqtari nuk është në përputhje me interesat e larta të gjykatës ku ai ushtron funksionin.

Nga të dhënat rezulton në mënyrë të qarte se organika e kësaj gjykate për shkaqe ligjore mund të cenohet në një të ardhme të afërme. Për më tepër duke iu referuar edhe ngarkesës aktuale të çështjeve në gjykim ajo është e konsiderueshme edhe për numrin aktual të gjyqtareve në këtë Gjykatë.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se komandimi i z. {...} në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, nuk është në përputhje me interesat me të larta të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Shkodër pasi kjo gjykatë, në rrethanat aktuale nuk ka mjaftueshëm gjyqtarë për ofrimin e shërbimit gjyqësor dhe si e tillë cenohet funksionaliteti i saj.

**Bazuar sa më sipër, me qëllim për të vijuar me procedurat e mëtejshme të komandimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:**

- Përfundimin e kandidatit z. {...}, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë për shkak të cenimit të funksionalitetit të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Shkodër.
- Publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS**